



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 307/5 prot.

Tiranë, më 1.8.2024

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 756, datë 9.4.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Klerona Meçi
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 19.7.2024, është njoftuar vendimi nr. 756, datë 9.4.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Klerona Meçi, me detyrë ndihmëse ligjore pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 756, datë 9.4.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Klerona Meçi, ushtron detyrën e ndihmëses ligjore pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe, në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1¹ e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Klerona Meçi, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (*në vijim referuar si Komisioni*), në zbatim të

¹ Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, Dh dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Raportin për vlerësimin e pasurisë nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), Raportin e vlerësimit të figurës nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si AKSIK) dhe Raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim referuar si KLP), nga të cilat rezultojnë se:

2.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Klerona Meçi”,² ka referuar se:

- i Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv Nuk ka kryer deklaram të rremë;
- v Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 AKSIK, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të Raportit mbi kontrollin e figurës nr. *** prot., datë **.10.2017, i DSIK-së, deklasifikuar plotësisht me vendim nr. ***, datë **.10.2023, të KDZH-së, ka referuar: “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Klerona Meçi”.

2.3 KLP, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, ka përcjellë pranë Komisionit Raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit, znj. Klerona Meçi³.

3. Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, ka vlerësuar si vijon:

3.1 Për vlerësimin e pasurisë. [...] 18.15. Komisioni, në përfundim të këtij hetimi administrativ, çmon se në vendimmarrjen e tij përfundimtare, siç konstatohet edhe më lart, duhet të marrë në konsideratë si vijon: (i) Subjekti ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e saj në përdorim dhe pronësi, siç parashikohet në pikën 1, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës. i. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj. Subjekti nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, në zotërim ose në përdorim të saj. ii. Mungesa e deklaramit të pasurisë së personit të lidhur, si e vetmja gjetje në kuadër të vlerësimit të pasurisë së subjektit, nuk është në atë shkallë sa të përbëjë shkak për shkarkim, sipas pikës 3 të nenit 61 dhe nuk ndikon në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit, duke cenuar besimin e publikut të drejtësisë. iii. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Klerona Meçi ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...].

3.2 Për kontrollin e figurës. [...] 19.22. Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Klerona Meçi, ka plotësuar në mënyrë korrekte deklaratën për kontrollin e figurës, pavarësisht dijenisë ose jo të saj lidhur me procedimin penal nr. ***, viti 2014, për veprën “Pastrimi i produkteve të veprës penale”; formalisht, emri i shtetasit ***. ***. nuk figuron si person i regjistruar në regjistrin e veprave penale si autor i veprës penale dhe, për pasojë, ai nuk mund të konsiderohet si kontakt i papërshtatshëm në kuptim të pikës 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”. 19.23. Sa më sipër, në kuptim të nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016: “Person i proceduar

² Shkresa e ILDKPKI-së me nr. ***/** prot., datë **.1.2018.

³ Raport i KLP-së nr. *** prot., datë **.6.2023.

penalisht nuk mund të konsiderohet personi të cilit kallëzuesi i atribuon një veprim të caktuar, që sipas vlerësimit të tij përbën veprë penale”[...].

3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale. [...]26. *Trupi gjykues çmon se, në bazë të dokumentacionit të analizuar më sipër, subjekti ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale [...].*

4. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme, për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbloodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 51, nenit 58, pika 1, shkronja “a”, si dhe nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash, ndër të tjera, ka vendosur: [...] *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Klerona Meçi, me detyrë ndihmëse ligjore pranë Prokurorisë së Përgjithshme [...].*

II. Vlerësimi i Komisionerit Publik

5. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting). Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

6. Në krahasim me kompetencat e njohura Komisionit dhe Kolegjit, nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

7. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

8. Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i vendimit nr. 756, datë 9.4.2024, çmon se ai përmban shkaqe ligjore për t’u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

9. Për sa më sipër, në konsideratë të faktit se Kolegji ka juridiksionin e posaçëm dhe të vetëm për të përcaktuar kualifikimet ligjore për çështjet që i përkasin procesit të rivlerësimit, juridiksion i cili lejon Kolegjin që të përcaktojë ligjërisht çdo rrethanë fakti nën parashikimet e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ushtron të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr. 756/2024 të Komisionit.

II.A Vlerësimi lidhur me aspekte të zbatimit të ligjit

10. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, në çështjen objekt shqyrtimi, shtrohet paraprakisht aspekti i zbatimit të ligjit, sa vijon:

10.1 Jurisprudenca e Kolegjit, lidhur me shkakun ligjor të “*cenimit të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë*”, ka vendosur standardin se është plotësisht e përshtatshme që institucionet e rivlerësimit të japin masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, pasi vetë ligji nr. 84/2016, në nenin 61, pika 5 e tij, autorizon në mënyrë specifike një masë të tillë disiplinore, në rastet kur subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut në sistemin e

drejtësisë, duke vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe objektive tërësinë e sjelljeve të subjektit të rivlerësimit dhe mbrojtjen e interesit publik në këtë proces.

10.2 Për sa i përket matjes së cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, jurisprudenca e Kolegjit ka vendosur standardin që institucionet e sistemit të drejtësisë duhet të gjenerojnë besim të vazhdueshëm te publiku, duke vepruar në mënyrë efektive dhe të drejtë, në përputhje me legjislacionin dhe duke e demonstruar këtë te qytetarët. Ka një sërë sjelljesh, nëpërmjet të cilave subjektet e rivlerësimit minojnë integritetin e institucioneve të drejtësisë dhe cenojnë besimin e publikut në sistemin tonë të drejtësisë, përmes korrupsionit, marrëdhënieve të rreme, shkeljes së betimit si nëpunës publik, veprimet në situatën e konfliktit të interesit, paaftësisë në punën profesionale, vendosjes së interesave privatë përpara interesit publik etj.

III. Analiza e shkaqeve të ankimit

III. A - Gjetje në kontrollin pasuror

11. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dorëzuar *Deklaratën e pasurisë* (në vijim referuar si D-Vetting) në datën **.1.2017, porse në referencë të detyrimit ligjor⁴ nuk rezulton të ketë dorëzuar formularët e Deklarimit të pasurisë nga personat e lidhur me subjektin e rivlerësimit, të cilët ishin pjesë e certifikatës familjare në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit, sipas formatit të Shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016.

11.1 Nga aktet në dosje rezulton e administruar certifikatë familjare e datës **.10.2016, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Gjirokastër, sipas së cilës znj. Klerona Meçi rezulton kryefamiljare, me gjendje civile beqare, pa persona të tjerë të përmendur në certifikatën familjare.

11.2 Komisioni, me aktin “*Rezultatet e hetimit administrativ*”,⁵ bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, për këto arsye: [...] *Neni 31 i ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën e pasurisë sipas Shtojcës 2 bashkëlidhur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon pranë ILDKPKI-së; Referuar Shtojcës 2 të ligjit, deklarata e pasurisë plotësohet nga subjekti i rivlerësimit që mbart detyrimin për deklarim të pasurisë së tij, të bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe të fëmijëve madhorë për çdo person të përmendur në certifikatën familjare, në bazë të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;* Në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, subjekti ka qenë në një trung familjar me persona të tjerë madhorë, të cilët duhet të plotësonin Deklaratën e pasurisë së personit të lidhur. Bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit⁶, duket se subjekti ka bërë deklarim të pamjaftueshëm në Deklaratën Vetting, duke shmangur nga deklarimi dhe kontrolli pasuritë e familjarëve [...].

11.3 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës⁷, shprehet se: [...] *Duke qenë se unë nuk kam qenë më parë subjekt deklarimi me detyrimin e plotësimit të deklarimit periodik të pasurisë, ishte hera e parë që plotësoja një deklaratë të tillë. Për këtë shkak, kam kërkuar verbalisht asistencën e punonjësve të ILDKPKI-së, të cilët më sqaruan se subjekte të lidhura me detyrim deklarimi nuk janë prindërit, për aq sa në momentin e deklarimit nuk bëjnë pjesë në certifikatën familjare...Unë jam ndarë nga trangu familjar në datën **.10.2016 dhe dorëzimi i deklaratës së pasurisë pranë ILDKPKI-së është bërë në datën **.1.2017... Në kushtet kur deklarimi i pasurisë bëhej për gjendjen e pasurive në momentin e deklarimit, në datën **.1.2017, kur kam plotësuar deklaratën e pasurisë, kam qenë e ndarë nga trangu*

⁴ Pika 13, e nenit 3, e ligjit nr. 84/2016.

⁵ Referohuni “Rezultateve të hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit, znj. Klerona Meçi, faqe nr. 3.

⁶ Referohuni vendimit (JR) nr. 11/2023, prg. 31; Vendimit (JR) nr. 20/2023, prg. 11.11; Vendimit (JR) nr. 46/2023, prg. 40-42.

⁷ Në prapësimet të datës 5.1.2024, lidhur me kriterin e pasurisë.

familjar... Ky mosdeklarim lidhet me mënyrën e të kuptuarit të hyrjes efektive në fuqi të ligjit nr. 84/2016 dhe me orientimet që kam marrë në kohën e plotësimit të deklaratës, pasi sikurse kam sqaruar më parë, nuk kam qenë kurrë subjekt deklarimi dhe deklarimi Vetting ka qenë deklarimi i parë i plotësuar nga ana ime [...].

11.4 Komisioni ka arritur në përfundimin se: [...]18.9. Trupi gjykues, pasi administroi provat e rezultuara gjatë hetimit, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në lidhje me prapësimet e saj me shkrim dhe në seancën dëgjimore, konstaton se 18.9.1 nga aktet e administruara gjatë hetimit rezulton se subjekti i rivlerësimit ka qenë pjesë përbërëse e familjes prindërore deri në datën **.10.2016⁸, ndërsa pas kësaj date gjendja familjare përbëhet vetëm nga subjekti i rivlerësimit. Trupi gjykues vëren se në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”, në datën **.10.2016, subjekti i rivlerësimit ka qenë në të njëjtën certifikatë familjare me prindërit. Për efekt të këtij ligji, bazuar në parashikimet e pikës 13, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, prindërit e subjektit të rivlerësimit, për shkak të qenies në të njëjtën certifikatë familjare, konsiderohen persona të lidhur që kanë pasur detyrimin për të deklaruar në deklaratën e pasurisë Vetting, duke bashkëlidhur të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të tyre. Ndarja e subjektit të rivlerësimit nga trangu familjar, disa ditë pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, nuk ka përjashtuar nga detyrimi ligjor për deklarimin e pasurive në Deklaratën Vetting prindërit e saj, të cilët kanë qenë pjesë e certifikatës familjare në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Trupi gjykues vëren se është përbërja e certifikatës familjare për gjithë periudhën e rivlerësimit, ajo që përcakton rrethin e personave të lidhur që duhet të deklarojnë në kuptim të nenit 3, pika 13, dhe të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, pavarësisht pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se prindërit e subjektit janë persona të lidhur dhe, me mosdeklarimin e tyre në Deklaratën Vetting, subjekti ka shmangur detyrimin për deklarim të pasurisë dhe të interesave privatë të personave të lidhur. Sa më sipër, subjekti ka bërë një deklarim të pasaktë në Deklaratën Vetting, pasi nuk ka deklaruar pasuritë e familjarëve të saj, të cilët, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, kishin detyrimin që të deklaronin interesat pasurorë në kuadër të procesit të rivlerësimit. 18.9.2. Trupi gjykues çmon se, duke qenë se analiza financiare e pasurisë së deklaruar nga subjekti në përdorim dhe në pronësi rezulton me burime të ligjshme dhe nisur nga fakti se subjekti nuk ka qenë asnjëherë subjekt deklarimi dhe pasuritë e disponuara nga ajo në përdorim e pronësi rezultojnë të krijuara me burime të ligjshme, kjo pasaktësi duhet të vlerësohet bazuar në parimin e proporcionalitetit [...].

11.5 Komisioneri Publik vlerëson se përfundimi i arritur nga Komisioni, për sa i përket detyrimit për deklarim në D-Vetting të personave të lidhur, është i drejtë, i bazuar në ligj dhe jurisprudencën e Kolegjit⁹, porse nuk ndan të njëjtin qëndrim mbi pasojën e shmangies së këtij detyrimi nga subjekti i rivlerësimit në rastin konkret, parë dhe vlerësuar në harmoni me specifikat e gjetjeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ.

11.5.1 Referuar sa më lart, për sa i përket përfundimit mbi ligjshmërinë e burimeve krijimit të pasurive në përdorim e pronësi të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, të kualifikuar si pasaktësi në deklarim, Komisioneri Publik nuk ndan të njëjtin qëndrim me Komisionin.

11.5.2 Mospërmbushja e detyrimit ligjor për të deklaruar burimin e krijimit të pasurive sipas përcaktimeve ligjore së bashku me mosdeklarimin në D-Vetting, të personave të lidhur dhe pasurive të tyre ka çuar më së paku në pamundësi të kontrollit nga organet e rivlerësimit, të pasurive të krijuara nga personat e lidhur¹⁰, dhe si rrjedhojë e bën deklarimin e subjektit të rivlerësimit të paplotë dhe të pavërtetë, vlerësuar kjo dhe në konsideratë të faktit se subjekti i

⁸ Nga aktet në dosje rezulton data **.10.2016.

⁹ Referohuni vendimit (JR) nr. 11/2023, prg. 31; Vendimit (JR) nr. 20/2023, prg. 11.11; Vendimit (JR) nr. 46/2023, prg. 40-42.

¹⁰ Referohuni jurisprudencës së Kolegjit në vendimet (JR) nr. 11/2020, prg. 20; Vendimit (JR) nr. 11/2022, prg. 32.13; Vendimit (JR) nr. 8/2024, prg. 16.3.

rivlerësimit, sikundër do të trajtohet dhe në vijim të këtij ankimi, edhe në përfundim të hetimit administrativ, nuk arriti të përmbysë barrën e provës, për të provuar bindshëm burimet e ligjshme të krijimit të pasurive në përdorim dhe pronësi të saj dhe personave të lidhur me të.

11.5.3 Referuar hetimit administrativ, ka rezultuar ndarja e subjektit të rivlerësimit nga trangu familjar në datën **.10.2016, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 dhe pas daljes së udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016,¹¹ të ILDKPKI-së, rrethanë kjo që duket se tregon qëllimin për të përjashtuar nga përgjegjësia ligjore për deklarimin e pasurive në D-Vetting familjarët, pjesë e certifikatës familjare në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit.

11.5.4 Deklarimet e subjektit të rivlerësimit mbi plotësimin e deklaratës së pasurisë për herë të parë dhe kërkesa verbalisht e asistencës së punonjësve të ILDKPKI-së, ndërkohë që ligji nr. 84/2016 dhe udhëzimi i ILDKPKI-së në zbatim të tij, ishin miratuar tashmë, nuk tregojnë qasjen e kërkuar prej saj në drejtim të zbatimit të ligjit¹², për sa dhe sikundër do të trajtohet në vijim ka rezultuar mbi pasuritë e personave të lidhur.

11.6 *Komisioneri Publik* vëren se, në rastin konkret, këto rrethana të konstatuara sa më lart, për shkak të nevojës së vlerësimit në harmoni me gjetjet në vijim të këtij ankimi duhen mbajtur në konsideratë për vlerësimin tërësor të procedurës së rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, për sa kohë që dhe në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit nuk parashtrroi shkaqe të tilla ligjore, që të sillnin përmbysjen e barrës së provës mbi pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme të pasurive në përdorim e pronësi, duke u gjetur kështu, subjekti i rivlerësimit, në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për efekt të kontrollit të pasurisë.

12. Pasuri në përdorim “Apartament banimi me sip. 102,6 m²”, ndodhur në *, Tiranë**

12.1 Në *D-Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *apartament banimi* me sip. 102,6 m², në *** ***, Tiranë, apartament në përdorim, blerë nga babai dhe në pronësi të tij. *Vlera*: 79.500 euro. *Pjesa takuese*: 0%. Bashkëlidhur ka depozituar kontratë sipërmarrje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.7.2016.¹³

12.2 Nga aktet në dosje rezulton se, sipas kontratës së sipërmarrjes të datës **.7.2016, me nr. *** rep. dhe nr. *** kol., shtetasi *** ***, ka porositur te shoqëria “****” sh.p.k., një ambient banimi me sip.102,6 m², në Komunën ***, Tiranë. Në kontratë është parashikuar se do të paguhej çmimi prej 79.500 euro, ku kësti i parë prej 40.000 euro do të likuidohet me firmosjen e kontratës dhe kësti i dytë, prej 39.500 euro, do të likuidohet me klering (*pllaka dhe hidrosanitare*), specifikat do të shoqërohen me një aktmarrëveshje të veçantë midis palëve¹⁴.

12.3 Në lidhje me kohën dhe shlyerjen e çmimit, prej 79.500 euro, ka rezultuar se kësti i parë, prej 44.360 USD, është paguar me transfertë bankare nga llogaria bankare e z. *** ***, në datën **.7.2016, në favor të “****” sh.p.k. dhe gjatë vitit 2018 janë shlyer kështu e tjera, konfirmuar dhe nga shoqëria ndërtuese “****” sh.p.k.¹⁵

¹¹ Udhëzim i Inspektorit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare e të tjerë, nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 187, datë 10.10.2016.

¹² Referohuni vendimit (JR) nr. 46/2022, të Kolegjit, prg. 7, lidhur me prg. 30.

¹³ Në përgjigje të pyetësorit standard të Komisionit, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se nga data ** janar 2017 dhe aktualisht banoj në adresën rruga “****”, Nd. *, H. *, Ap. **, ***, ***, ***, Tiranë. Apartamenti është në pronësi 100% të babait, blerë me Kontratën e Sipërmarrjes me nr. *** kol. / *** rep., datë **.7.2016.

¹⁴ Agjencia Shtetërore e Kadastrës, me shkresat nr.***/* prot. dhe nr. ***/* prot., të datës *.2.2021, si dhe shkresën nr.***/* prot., datë *.2.2021, informon Komisionin se nuk ka pasuri të regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit apo personave të lidhur me të.

¹⁵ Referohuni shkresës kthim-përgjigje nr. **/* prot., datë *.5.2023, ku shoqëria konfirmon se vlera e kontratës është 79.500 euro dhe klienti *** ***, ka likuiduar vlerën prej 78.215 euro, diferenca prej 1.285 euro do të likuidohet kur apartamenti të

12.4 Lidhur me analizimin e burimeve të ligjshme për shlyerjen e pagesave për blerjen e kësaj pasurie, Komisionit, nga analiza financiare e hartuar për të vlerësuar mundësinë financiare të z. ***, ***, babai i subjektit të rivlerësimit, për të justifikuar blerjen e pasurisë, i ka rezultuar se: (i) *Në lidhje me pagesën e këstit të parë, në shumën 44.360 USD (40.000 euro), në datën **7.2016, ka rezultuar se kjo pagesë është kryer nga llogaria bankare në USD pranë *** Bank, në emër të babait të subjektit, llogari e hapur në datën **6.2013 dhe në të cilën, në datën **7.2013, është transferuar shuma prej 166.980 USD, arsye për të cilën analiza financiare e Komisionit është fokusuar për të vlerësuar nëse babai i subjektit kishte të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e shumës 166.980 USD;* (ii) *Në lidhje me pagesën e kësteve të çmimit të blerjes së këtij apartamenti, likuiduar në vitin 2018, në shumën totale 38.214,75 euro, në konsideratë të shpenzimeve të jetesës minimalisht vetëm për shtetasin ***. ***, për këtë periudhë, si dhe blerjen e autoveturës në pronësi të subjektit të rivlerësimit, pa llogaritur pasuri të tjera të krijuara, shpenzime të kryera, si dhe të ardhura të tjera, Komisioni ka konstatuar se duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të dokumentojë burimin e të ardhurave të babait të saj për shlyerjen e kësteve të çmimit të blerjes së apartamentit gjatë vitit 2018.*

12.5 Komisioni, me aktin “Rezultatet e hetimit administrativ”,¹⁶ bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, pasi: [...] (i) *Transaksionet e kryera ndërmjet shtetasit ***. ***, shoqërisë ndërtuese “***” sh.p.k. dhe shoqërisë “***” sh.p.k. (e cila ka për ortak dhe administrator shtetasin *** ***), kanë sjellë një paqartësi në lidhje si me çmimin e blerjes së apartamentit në përdorim nga subjekti i rivlerësimit, ashtu edhe me mënyrën e likuidimit të tij;* (ii) *Duket se nuk është arritur dokumentimi nga subjekti i rivlerësimit, i burimit të ligjshëm të të ardhurave të babit të saj për blerjen e apartamentit me sip. 102,6 m², në *** ***, Tiranë [...].*

12.6 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka depozituar *Raport ekspertimi*, si dhe disa kontrata kapari, që i përkasin periudhës 2009 – 2013, të nënshkruara në cilësinë e kaparmarrësit nga i ati, z. ***, *** dhe dy aksionarët e tjerë të shoqërisë “***” sh.p.k.

12.7 Komisioni ka riçelur hetimin administrativ¹⁷ dhe, në përfundim të tij, pasi ka rishikuar analizën financiare, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, pasi përsëri ka konstatuar se¹⁸: [...] (i) *për pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në Deklaratën Vetting përkatësisht: (1) apartamenti i banimit në përdorim nga subjekti i rivlerësimit, dhe (2) automjeti në pronësi të subjektit të rivlerësimit, pasuri këto të deklaruara nga subjekti me burim krijimi të ardhurat nga babai i saj, z. ***. ***, edhe pas riçeljes se hetimit duket se nuk provohet mundësia financiare e krijimit të tyre nga babai i subjektit të rivlerësimit [...]*¹⁹.

12.8 Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit, lidhur me rezultatet e hetimit shtesë, në mënyrë të përmbledhur, ndër të tjera, ka kundërshtuar kryerjen e analizës financiare për periudhën deri në qershor të vitit 2013; ka pretenduar përfshirjen në analizë e të ardhurave

pajiset me certifikatë pronësie. Shoqëria ka sqaruar se *marrëveshja me klering, e cituar në këstin e dytë, prej 39.500 euro, në nenin 3 të kontratës së sipërmarrjes nr. ***/***, redaktuar më **7.2016, nuk është nënshkruar asnjëherë nga palët, pasi ata dakordësuan për shlyerjen me këste si më sipër.*

¹⁶ Referohuni “Rezultateve të hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit, znj. Klerona Meci, faqe nr. 6-10.

¹⁷ Me vendim të ndërmjetëm nr. *, datë **1.2024.

¹⁸ Referohuni f. 4 të rezultateve të hetimit administrativ shtesë.

¹⁹ Në rezultatet shtesë të hetimit administrativ, Komisioni, në përfundimet e tij, ka referuar se: Komisioni vlerëson të nënvizojë se pamundësia financiare e babait të subjektit do të thellohej, nëse analiza financiare do të përfshinte edhe: (i) investimin për blerje pasurish të paluajtshme dhe të luajtshme nga shtetasi ***. *** (përfshirë blerje të apartamentit me sip. 57 m² në Sarandë, me kontratë në datën **3.2013, në vlerë 2.969.472 lekë; blerje të një sip. trualli në datën **3.2009, në shumën 151.888 euro (122.300 euro+29.588 euro); (ii) Shpenzimet për leje ndërtimi në datën **6.2009, në shumën 5.386.155 lekë, nga llogaria bankare personale e *** ***, në *** Bank, si dhe (iii) Depozitat e krijuara në emër të familjarëve dhe shpenzimet e udhëtimit/qëndrimit jashtë vendit.

nga shoqëria “****” sh.p.k., të ardhurave nga interesat bankare të Fondit të Investimeve²⁰, duke pretenduar se për krijimin e fondit të investimit janë përdorur, ndër të tjera, edhe likuiditetet e përfituara nga arkëtimi i shumave të përcaktuara në kontratat e kaparit, të ardhurat nga kontratat e kaparit, sepse janë të ardhura që nuk i nënshtrohen tatimit, përveç se në momentin e realizimit të shitjes përfundimtare, të ardhurat nga aktiviteti si blegtor i gjyshit të subjektit; si dhe ka pretenduar që Komisioni ta vlerësojë përdorimin e apartamentit në raport me pjesën e saj takuese të përdorimit, sepse këtë apartament e ka pasur në përdorim bashkë me motrat, që jetojnë në Tiranë për arsye studimi, duke paraqitur një tjetër raport vlerësimi të audituesit të pavarur.

12.8.1 Komisioni, pas administrimit të prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, ka arritur në përfundimin se: [...] 16.11 *Trupi gjykues, pasi administroi provat e rezultuara gjatë hetimit, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në lidhje me prapësimet e saj me shkrim dhe në seancën dëgjimore, konstaton se subjekti ka bërë një deklaram të saktë e të mjaftueshëm të pasurisë që ka në përdorim. Subjekti është emëruar në detyrën e saj si ndihmëse ligjore në datën **11.2015 dhe pasuria është porositur nga babai i saj në datën **7.2016, pra rreth 8 muaj nga koha e emërimit të saj. Elementi i dytë i marrë në analizë është e drejta e përdorimit, për të cilën subjekti ka bërë një deklaram të plotë dhe të saktë, duke saktësuar se kjo si pasuri ishte përdorur për nevojat e studimit dhe të punësimit dhe të fëmijëve të tjerë të familjes, të cilët studiojnë dhe punojnë në Tiranë. Subjekti ka përmbushur detyrimin ligjor, duke e deklaruar këtë pasuri në përdorim. 16.12 Lidhur me elementin tjetër të analizës, burimi i ligjshëm i krijimit të saj nga personi i lidhur, trupi gjykues çmon se, nisur nga fakti që është e provuar se pagesa e kësteve të kësaj pasurie është bërë nëpërmjet një transaksioni bankar nga llogaria në ****, në analizën financiare të Komisionit, duke marrë në konsideratë faktin se burimi i krijimit të saj nuk janë vetëm të ardhurat e personit të lidhur si aksionar apo i punësuar, por dhe interesat e kësaj llogarie, trupi gjykues çmon se vlera e këtyre interesave është një e ardhur e tatuar e, për pasojë, burimi i krijimit të kësaj pasurie është i ligjshëm. Nga hetimi rezultoi se të ardhurat neto nga interesat bankarë në ****, nga periudha shkurt 2013 – korrik 2016, janë në vlerën 12,383,909 lekë. 16.13 Komisioni çmon se, edhe nëse do të konsiderohet si e tillë mungesa e burimeve të ligjshme që rezulton nga analiza financiare e kryer, duke mos përfshirë të ardhurat e babait nga interesat bankarë, nuk duhet të konsiderohet si një rrethanë që e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016; 16.16 Në përfundim, për sa më sipër, Komisioni çmon se edhe mungesa e burimeve të ligjshme, që mund të rezultojë nga analiza financiare e kryer, duke mos përfshirë në të të ardhurat nga interesat bankarë, nuk duhet të konsiderohet si një rrethanë që e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 [...].*

12.9 Komisioneri Publik, për sa i përket përfundimit të arritur për pasurinë e paluajtshme “apartament me sipërfaqe 102,6m²”, ndodhur në ****, Tiranë, ndan qëndrim të ndryshëm për sa vijon:

12.9.1 Në vlerësim të akteve në dosje, gjendet i pambështetur vlerësimi i Komisionit mbi konsiderimin në mesin e burimeve të ligjshme të personit të lidhur të të ardhurave neto nga interesat bankarë, përfituar nga investimet e personit të lidhur pranë ****²¹, pasi, së pari, nga aktet në dosje, nuk duket që transaksioni i pagesës të *këstit të parë* të apartamentit të ketë të bëjë vetëm me interesat e akumuluar nga fondi ****. Ashtu sikundër ka rezultuar edhe

²⁰ Të cilat subjekti i rivlerësimit i ka pretenduar dhe si burim për mbulimin e pagesave të kryera gjatë vitit 2018, në *Prapësimet e rezultateve shitesë të hetimit administrativ*.

²¹ Trajtuar në pikën 16.12 e në vijim të vendimit të arsyetuar.

nga hetimi administrativ i Komisionit në këtë llogari, ka rezultuar se janë kryer disa transaksione të ndryshme²².

12.9.2 Komisioneri Publik konstaton, po ashtu, se nga korrespondenca me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjirokastër, rezulton i regjistruar Procedimi penal me nr. ***, datë **.5.2014, mbi bazën e materialeve referuese të përcjella nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Gjirokastër, ndaj shtetasit ***. ***, për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Gjatë hetimit penal, prokurori i çështjes, më datë **.5.2014, ka nxjerrë vendim për sekuestrimin e llogarive bankare të shoqërive “****” sh.p.k. dhe “**** ” sh.p.k., në të cilat personi i lidhur, shtetasi ***. ***, rezulton ortak/administrator, si dhe ato personale të shtetasit ***. ***, vendim i shfuqizuar pjesërisht me vendimin me nr. **, datë **.6.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Gjirokastër. Me vendimin e datës **.12.2014, të prokurorit të çështjes, është vendosur pushimi i hetimeve të çështjes penale me nr. ***, të vitit 2014, ku në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, lidhur me transaksionet në llogaritë personale të shtetasit ***. ***, ndër të tjera, në mënyrë të përmbledhur është arsyetuar se: [...] *ka rezultuar se vlerat monetare në llogaritë personale duhet të kishin kaluar në llogaritë apo arkën e shoqërive “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k., por, praktikisht, kanë kaluar në llogaritë personale të shtetasit ***. ***, i cili, nëpërmjet llogarive të hapura në bankat e nivelit të dytë, të gjitha vlerat monetare të kaluara në emër të tij i ka përdorur për të kryer pagesa në drejtim të shoqërisë “****” sh.p.k... gjithashtu një pjesë të këtyre vlerave monetare, shtetasi ****. ***, i kishte përdorur për hapje depozitash, prej të cilave kishte përfituar interesa, si dhe masën më të madhe në fondin e investimit pranë **** **... pavarësisht kësaj, vlerat monetare duhet të kishin kaluar në arkat/llogaritë bankare të shoqërive respektive, pas kësaj shoqëritë në fjalë, nëpërmjet dokumentacionit kontabël, duke përfshirë edhe këto vlera, do të duhej të kishin llogaritur fitimet për çdo vit dhe pasi këto fitime t’i ishin nënshtruar tatimeve, atëherë ato mund të kalonin në favor të ortakëve të shoqërive, ku njëri prej tyre ishte edhe shtetasi ***. ***[...].*

12.9.3 Në D-Vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga punësimi në shoqërinë “****” sh.p.k., me funksionin *juriste*, për periudhën **.4.2014 - **.12.2015, shoqëri në të cilën personi i lidhur, z. ***. ***, rezulton ortak me 65% të kuotave dhe administrator i saj, periudhë që i korrespondon edhe procedimit penal sa më lart trajtuar.

12.9.4 Nga korrespondenca me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjirokastër rezulton se një ndër llogaritë e sekuestruara sipas vendimit të prokurorit, të datës **.5.2014, është edhe llogaria në USD pranë *** Bank,²³ nga e cila është bërë pagesa e *këstit të parë*, për pasurinë *apartament me sipërfaqe 102,6 m²*, sikundër trajtuar në pikën 12.4 “i” të këtij ankimi.

12.9.5 Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte burimin e ligjshëm të personit të lidhur edhe në përgjigje të rezultateve të hetimit shtesë, pasi, për sa i përket pretendimeve të subjektit, mbi përfshirjen në mesin e burimeve të ligjshme të të ardhurave nga kontratat e kaparit, me riçeljen e hetimit administrativ, referuar akteve të përcjella nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjirokastër, në vendimin e pushimit të procedimit penal nr. ***, datë **.12.2014, sikundër trajtuar dhe më sipër, është konstatuar, ndër të tjera, se vlerat e investuara në llogari personale/depozita/fonde investimi në emër të personit të lidhur, të atit të subjektit, kanë si burim dhe likuidime të kontratave të

²² Llogaria rezulton e çelur më datë **.6.2013 dhe, në datën **.7.2013, në të është transferuar me këmbim shuma prej 166.980 USD, shumë nga e cila, në datën **.4.2014, është tërhequr në *cash* shuma prej 10.000 USD, në datën **.4.2014, është dhënë hua shtetases ***. ***. shuma prej 137.000 USD, hua e cila është kthyer në datën **.4.2014, në shumën 137.500 USD, në datën **.5.2014, nga kjo llogari është transferuar për ortakun tjetër, shuma prej 100.000 USD dhe gjendja në llogari ka mbetur në vlerën 57.491 USD.

²³ Informacioni i vënë në dispozicion nga DPPPP, lidhur me këtë procedim, referon transaksione në vlera të larta, kryesisht në llogaritë personale të babait të subjektit të rivlerësimit, në *** Bank, në vlerat rreth 300.000 euro dhe *** ***, në vlerën rreth 1.1 milionë euro.

kaparit, të cilat, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi mbi funksionimin e shoqërive tregtare, në vend të kanalizoheshin në arkën apo llogaritë e shoqërive, për t'u regjistruar si shitje dhe paguar detyrimet tatimore për to, janë kanalizuar në llogaritë personale të personit të lidhur, z. ***. ***, duke mos plotësuar kështu kushtin e parashikuar në nenin D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, mbi pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat e deklaruara²⁴.

12.9.6 Përveç sa më sipër, nga hetimi administrativ në emër të personave të lidhur, për periudhën deri korrik 2013, kanë rezultuar investime të konsiderueshme në pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, konkretisht:

12.9.6.1 Nga korrespondenca me bankat e nivelit të dytë, kanë rezultuar investime në kursime në formën e depozitave bankare apo fondeve të investimit të personave të lidhur, konkretisht: (i) *** Bank, me shkresë nr.***/* prot., datë **.1.2021, dhe *** ***, me shkresën nr. ***/* prot., datë **.1.2021, konfirmojnë se në llogaritë personale të personit të lidhur, të atit të subjektit, duke nisur nga viti 2008, evidentohen transaksione, kryesisht depozitime në *cash*, në shuma të konsiderueshme në llogaritë rrjedhëse, si dhe investime në depozita me afat në shuma të konsiderueshme²⁵, të cilat pjesërisht i ka konvertuar në monedha të huaja dhe pjesërisht i ka investuar në fonde investimi. Deri në momentin e krijimit të shumës së marrë në analizë, sipas këtij informacioni rezulton se ka pasur kursime të konsiderueshme në formën e depozitave bankare pranë *** Bank (rreth 20.000.000 lekë fonde në llogari rrjedhëse/depozitë) dhe investime pranë fondit të investimit *** *** (në vlerën rreth 140.000.000 lekë); (ii) ***, me shkresë nr. ***/* prot., datë **.2.2024, konfirmon depozitë në emër të personit të lidhur ***. ***, në shumën 1.000.000 lekë, krijuar nëpërmjet depozitimit në *cash* të kësaj vlere, në datën **.2.2013.

12.9.6.2 Nga korrespondenca me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës,²⁶ Sarandë dhe Gjirokastër konfirmohen disa pasuri të paluajtshme në emër të personit të lidhur, z. ***. ***, konkretisht *apartment*, me vlerë 2.969.472 lekë, fituar me kontratën e shitjes nr. ***/***/**, datë **.2013, pasuria me nr. */**+*-** vol. ***, f. ***, nr. **, datë **.3.2011, e llojit *apartment*, me vlerë 2.365.500 lekë; pasuria me nr. */** - ** vol. **, f. **, nr. **, dt. **.3.2011, e llojit *garazh*, me vlerë 912.000 lekë; pasuria me nr. */** - ** regj. Hip. *** dt. **.10.2010, pasuri e llojit *ndërtim*; pasuria me nr. ***/** - ** regj. **, me kontratë shitblerje nr. ***/***, datë **.3.2009, pasuri e llojit *truall*, me vlerë 13.920.000 lekë (*kontratë për të cilën babai i subjektit ka nënshkruar në cilësinë e individit, si një nga tre blerësit, dhe sipas përcaktimeve në kontratë, blen 50% të pasurisë*); pasuri nr. */** vol. **, f. **, z. k. ***, ndërtim me sip. 761 m², me kontratë shitblerje nr. ***/***, datë **.6.2005, me vlerë 3.191.000 lekë (*kontratë për të cilën babai i subjektit ka nënshkruar në cilësinë e individit si një nga tre blerësit*); pasuri nr. */**, me sip. 335 m², z. k. nr. ***, dhe */***, me sip. 65 m², blerë me kontratë shitblerje nr. ***/**, datë *.2.2005, në vlerën 23.500.000 lekë (*kontratë për të cilën babai i subjektit ka nënshkruar në cilësinë e individit si një nga tre blerësit*).

12.9.7 Bazuar në sa më sipër arsyetuar në pikën 11 e në vijim të këtij ankimi, mbi konsiderimin e familjarëve të subjektit si persona të lidhur, referuar parashikimeve të pikës 13, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, parashikimeve të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, si dhe jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit²⁷, në vlerësimin e Komisionerit Publik, analiza financiare duhet të përfshijë të gjithë të ardhurat e ligjshme sipas parashikimeve të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, si dhe të gjithë investimet në pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, evidentuar gjatë hetimit, për subjektin dhe personat e lidhur me të.

²⁴ Konfirmuar dhe nga Komisioni në prg. 16.14 të vendimit të arsyetuar.

²⁵ Vetëm gjatë vitit 2008 rezultojnë depozitime kryesisht në *cash* në llogarinë e tij personale, në shumën rreth 23.000.000 lekë.

²⁶ Shihni shkresën nr. ***/* prot., datë **.2.2023, ASHK Sarandë dhe me shkresë nr. ***/* prot., datë **.3.2024, ASHK Gjirokastër.

²⁷ Referohuni vendimit (JR) nr. 20/2023, prg. 11.11.

12.9.8 Investimet e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit, në pasuri të luajtshme e të paluajtshme të personave të lidhur me subjektin, tejkalojnë ndjeshëm edhe tepricën pozitive të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit në prapësimet e saj ndaj rezultateve të hetimit shtesë, edhe në një skenar tejet garantist për rastin në fjalë²⁸.

12.9.9 Konkluzioni i Komisionit se, vetëm të ardhurat nga interesat e përfituara nga investimet e personit të lidhur pranë *** ***, janë në një vlerë të tillë që mbulojnë burimet e krijimit të pasurive në fjalë, nuk gjendet i mbështetur, pasi, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit²⁹, analiza në fjalë nuk mund të lidhet vetëm me disponibilitetin e kursimeve në llogari bankare/fonde investimi, pa u verifikuar burimi i ligjshëm i fondeve të investuara.

12.9.10 Edhe në konsideratë të pretendimeve të subjektit mbi shtrirjen e analizës financiare përtej vitit 2013³⁰, deri në momentin e pagesës së këstit të parë të apartamentit, korrik 2016, nga aktet si më sipër listuar, ka rezultuar se personat e lidhur me subjektin kanë vazhduar të kryejnë investime në pasuri të paluajtshme dhe investime në pasuri të luajtshme, kursime në depozita bankare edhe gjatë kësaj periudhe³¹. Pretendimet e subjektit për përfshirje të të ardhurave nga aktiviteti blegtoral i gjyshërve, përveçse duket se janë një burim i ri i shtuar vetëm në përfundim të hetimit administrativ shtesë, mbetën të paprovuara, për sa kohë që mbështeten në deklarata noteriale të hartuara gjatë procesit të rivlerësimit³².

12.10 Komisioneri Publik, në përfundim, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në kuadër të detyrimit që ka pasur për deklarimin e personave të lidhur dhe pasurive të tyre, si dhe justifikimin e burimeve të krijimit të këtyre pasurive, nuk provoi të kundërtën e barrës së provës, duke u gjendur në kushtet e zbatimit të parashikimit të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

12.10.1 Për sa i përket pasurisë së luajtshme *automjet*, me targë ***, deklaruar në pronësi nga subjekti i rivlerësimit në D-Vetting, për sa kohë që si burimi i krijimit të tij deklarohen të ardhurat personale të z.***. *** dhe përfundimi i Komisionit për këtë pasuri bazohet në të njëjtën linjë arsyetimi, sikurse për pasurinë e paluajtshme “*Apartament me sipërfaqe 106,2 m²*”, ndodhur në ***, Tiranë, përfundimi i mësipërm, i arritur nga Komisioneri Publik, gjen vend për zbatim edhe për këtë pasuri.

13. Në përfundim, vlerësohet se sjellja e subjektit të rivlerësimit me mosdeklarimin e personave të lidhur në D-Vetting, veprimi i shkëputjes nga certifikata familjare në momentin kur ligji nr. 84/2016 ishte në fuqi, shoqëruar me mungesën e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive për sa trajtuar gjerësisht më sipër, janë rrethana që tregojnë për një qasje të subjektit të rivlerësimit që e vendosin këtë të fundit në kushtet e zbatimit të nenit 61, pika 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016.

IV. Kërkimi i ankimit

14. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se vendimi i Komisionit nuk është në pajtueshmëri të plotë me gjendjen e fakteve dhe provave të administruara në fashikull, për krijimin e bindjes se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë, në kuptim të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016;

15. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë

²⁸ Në investimet deri në këtë periudhë nuk janë përfshirë huat që i ati i subjektit duket se i ka dhënë shoqërive ku është ortak, referuar të dhënave të pasqyrave financiare depozituar në QKB.

²⁹ Referohuni vendimit (JR) nr. 52/2023, prg. 13.30.

³⁰ Subjekti e lidh këtë pretendim me momentin e pagesës së këstit të parë, që i përkon periudhës korrik 2016.

³¹ Sikundër ka rezultuar nga konfirmimet e bankave të nivelit të dytë dhe ASHK.

³² Deklaratë noteriale, datë **3.2024, me deklarues ***, dhe ***, ***.

në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

16. Komisioneri Publik, bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 59, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkon nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të vendosë:

- *Ndryshimin e vendimit nr. 756, datë 9.4.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Klerona Meçi.*

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA